

Data 28.12.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Shërbim mobile

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Rrjeti internet- 32412110-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit: 1.896.400 (një milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Qendra Kombetare e Urgjences Mjekesore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë/Autorizim individual të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për shërbimin e kërkuar me mbulim në të gjithë territorin

e Republikës së Shqipërisë. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e çertifikatës përkatëse, e cila duhet të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3 neni 8 g):

3. “Autorizim i përgjithshëm” është një akt i natyrës së përgjithshme, që përbëhet nga kuadri ligjor, i përcaktuar nga ky ligj dhe rregullat e nxjerra nga AKEP-i, në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrimet specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe /ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatorë, të përcaktuara nga ky ligj, AKEP-i ka kompetencë:

g) lëshon autorizimet individuale për përdorimin e frekuencave;

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kriteri: Xhiroja mesatare vjetore për 3 vitet e fundit duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit. Sqarohet se kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ne nenin 55 të VKM nr.285 parashikohet:

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Parashikimi prej jo më pak se 40 % është bere me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes se operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM nr.285, neni 43, pika 1:

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi **deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare**.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

Kapaciteti teknik:

Kriteri: Sherbime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës se perlloritur te fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme.

- Për kontrata me institucionet shtetërore duhet të paraqitet kontrata dhe vërtetimi për realizimin me sukses të saj ose kontrata dhe faturat tatimore të shitjes.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Faturat duhet **të jenë të deklaruara në organet tatimore**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 55, pika 4, b) të VKM Nr.285:

b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlloritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Kriteri: Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin tekniko-profesional të paktën 5 specialistë të fushave të Inxhinierisë Elektronike/Informatike ose Telekomunikacionit.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a- Diplomën e studimeve universitare në këtë fushë, kontratë pune dhe të jenë të siguruar aktualisht pranë OE.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 paragrafi b) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë personelin e tyre te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

Të gjithë specialistët e kërkuar janë të nevojshëm për realizimin e shërbimeve të kërkuara në specifikimet teknike të kësaj procedure.

Disponimi i stafit teknik të kërkuar krijon bindje tek Autoritetin Kontraktor se OE ofertues ka kapacitetet profesional për realizimin e kontratës.

Kriteri: Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike dhe termave të referencës. AK ruan të drejtën e verifikimit në cdo kohë të informacionit të paraqitur nga OE

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 e VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Kriteri: Operatori ekonomik duhet të paraqesë skemën e përgjithshme të rrjetit të vet, për të vërtetuar se disponon rrjet backbone të mbrojtur të paktën në 2 drejtime në mënyrë që të mënjanohe problemet në rastin e dëmtimit të një drejtimi dhe të ketë DRS (Disaster Recovery Site) në një vendndodhje tjetër gjeografike (qytet)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 e VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Kriteri: Operatori duhet të paraqesë skemën përkatëse të lidhjes fizike nga vendodhja e QKUM deri në Pikën e Prezencës (POP) të Operatorit Ekonomik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 e VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Kriteri: Operatori ekonomik duhet të ketë të certifikuar një punonjës për sigurinë kibernetike. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

-Diplomën, certifikate për sigurinë kibernetike, si dhe të jetë i siguar aktualisht pranë OE.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 paragrafi b) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Kriteri: Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme:

- ISO 9001:2015 ose ekuivalente (për sistemin e menaxhimit të cilësisë)
- ISO 27001:2013 ose ekuivalente (për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit)
- BS PAS 99:2012 ose ekuivalente (për sistemin e menaxhimit të integruar)

Në rast bashkimi operatorësh secili operator duhet të paraqesë certifikatat përkatëse.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 dhe 79, të LPP ku parashikohet se:

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar .

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Emërtimi	Sasia	Afati
Internet për QKUM	50/50 Mbps	12 muaj, deri në 31.12.2024
Shërbim telefonik E1 PRI ISDN	2 linja hyrëse dhe një dalëse	12 muaj, deri në 31.12.2024

- Operatori duhet të ofroje 50mbps/50mbps Cir 99% IP reale
- Skemen teknike dhe shtrirjen gjeografike të linjes primare dhe Back Up të shërbimit si dhe deklaratën për IP Publike të venë në dispozicion sipas kërkesës së mesipërme.
- Operatori duhet të disponojë AS të regjistruar pranë RIPE NCC (European IP Networks).IP STATIKE
- Teknologjia e përdorur për ofrimin e shërbimit duhet të jetë Fiber optike
- Infrastruktura: Fiber Optike e mbrojtur nga dy drejtime të ndryshme në lidhjen fundore.
- Rrjeti dhe shërbimi nuk duhet të prekin konfigurimin e tanishëm të adresave IP publike të rrjetit.
- Rrjeti i komunikimeve elektronike (Data dhe Internet) të operatorit duhet të bazohet në teknologjinë IP-MPLS
- Operatori duhet të ketë support për BGP.
- Operatori duhet të ofrojë shërbimi pa përdorur rrjetin e operatorëve të tjerë.
- Operatori duhet të disponojë strukturë Helpdesk të dedikuar, të kontaktueshëm 24/7/365.
- Operatori duhet të ofrojë monitorim IP SLA të linkut.
- Në rast problemi a defekti nderhyrja duhet të jetë e menjehershme, e shpejte dhe efiçente.
- Të ketë planin e vet të numeracionit

El PRI ISDN për shërbimin PABX

- Lloji i sinjalizimit: PRI ISDN
 - Numri i Kanaleve për çdo El: 30 Kanale
 - Bandwidth për çdo El: 2Mbps
 - Infrastruktura: Fibër Optike e mbrojtur nga dy drejtime të ndryshme në lidhjen fundore.
- Nr i El: 3 (tre) El
 - Dy nga linjat El PRI ISDN do të jenë të konfiguruar vetëm për thirrje hyrëse
 - Një linjë El PRI ISDN e cila do të jetë e konfiguruar për thirrje hyrëse –dalëse (bidirectional)
- Teknologjia e përdorur për ofrimin e shërbimit do të jetë Fiber optike
- Numri i brendshëm nuk duhet të ndryshojë tek E1 dy drejtimesh, pasi serverat Institucionale të enteve të tjera publike janë të konfiguruar me këtë numër.
- Operatori duhet të disponojë rrjet backbone të mbrojtur të paktën në 2 drejtime në mënyrë që të menjanohej problemet në rastin e dëmtimit të një drejtimi dhe të ketë DRS (Disaster Recovery Site) në një vendndodhje tjetër gjeografike (qytet). Për këtë pikë të paraqesë skemën e përgjithshme të rrjetit të vet.
- Operatori duhet të ofrojë shërbim pa përdorur rrjetin e operatorëve të tjerë.

- Operatori duhet të disponojë strukturë Helpdesk të dedikuar, të kontaktueshëm 24/7/365.
- Në rast problemi a defekti ndërhyrja duhet të jetë e menjëhershme, e shpejtë dhe efiçente.
- Operatori Ekonomik duhet të marrë përsipër në çmimin e ofruar të përfshijë dhe sasinë e minutave si më poshtë:
 - Drejt operatoreve FIX – 10,000 Minuta ne muaj
 - Drejt operatoreve Mobile – 200,000 minuta ne muaj
- Numrat si më poshtë shënuar duhet të jenë pjesë e series numerike të operatorit ekonomik të licensuar për dhënien e shërbimit të telefonisë fikse dhe duhet që operatori të sigurojë konfigurimet e nevojshme teknike që thirrjet hyrëse drejt këtyre numrave të devijohen në mënyrë automatike drejt platformës qëndrore të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore.
 - 042222235 - Tiranë
 - 031122730 - Kucovë
 - 024222573 - Kukës
 - 083224444 - Pogradec
 - 085222312 - Sarandë
 - 021522222 – Lezhë

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore